



## Njoftim për shtyp

### **Progres Raporti i Komisionit European 2017 në lidhje me Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”**

Komisioni European (KE) ka publikuar Progres Raportin 2017 për Shqipërinë dhe Hapjen e Negociatave për Anëtarësim në Bashkimin European (BE).

KE ka dhënë vlerësimet për Autoritetin e Konkurrencës (AK) në rolin e liderit dhe koordinatorit për kapitullin 8 "Politika e Konkurrencës". *Sipas Progres Reportit, në fushën e politikës së Konkurrencës, niveli i përgatitjes së Shqipërisë është i moderuar.*

Si më poshtë gjetjet e Progres Reportit 2017 për Kapitullin 8:

“Rregullat e BE-së për Politikën e Konkurrencës mbrojnë konkurrencën e lirë në treg. Ato përfshijnë rregulla antitrust kundër marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve dhe abuzimit me pozitën dominuese, dhe gjithashtu përfshijnë rregulla për përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve që do të pengonin ndjeshëm konkurrencën. Rregullat e BE-së gjithashtu parandalojnë dhënien e ndihmës shtetërore nga qeveria e cila mund të shkaktojë shtrembërimin e konkurrencës.

Në fushën e politikës së Konkurrencës, niveli i përgatitjes së Shqipërisë është i moderuar. Gjatë periudhës raportuese ka pasur disa përparime në fushën legjislativë. Megjithatë, janë të nevojshme përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar më tej harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore.

*Në vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:*

- të sigurojë pavarësinë në veprimtarinë e Komisionit të Ndhmës Shtetërore (KNSH) dhe të forcojë kapacitetin e Njësisë së Ndhmës Shtetërore;
- të rrisë përpjekjet për të përmirësuar zbatueshmërinë e ligjit në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore.

## **Marrëveshjet e ndaluara, Pozita dominuese dhe Kontrolli i Përqendrimeve**

*Kuadri ligjor* është gjerësisht në përputhje me *acquis* dhe dispozitat e MSA-së. Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është kryesisht në përputhje me nenin 101 mbi marrëveshjet e ndaluara dhe nenin 102 për abuzimet me pozitën dominuese të TFEU. Ai parashikon gjithashtu kontrollin paraprak të përqendrimeve, në përputhje me Rregulloren e Përqendrimeve. Legjislacioni sekondar është kryesisht në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe udhëzimet e KE. Në vitin 2016, AK përdori procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve dhe rregulloren mbi procedurat e angazhimeve.

Për sa i përket *kuadrit institucional*, AK është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. AK është një autoritet i cili, në mënyrë të pavarur, raporton në Kuvend. Kryetari i tij dhe katër anëtarët e komisionit emërohen nga Kuvendi. AK-ja mund të miratojë legjislacionin dytësor, të vendosë gjopa dhe sanksione nëse shkelen rregullat e konkurrencës, autorizon përqendrimet e ndërmarrjeve me ose pa kushte, ose i ndalon ato. AK mund të kryejë hetime sektoriale dhe, me iniciativën e vet, nxjerr opinione dhe rekomandime mbi projektligjet që mund të ndikojnë konkurrencën. Për ndërmarrjet që japin informacion mbi rastet e karteleve është në fuqi “Programi i lehtësimit nga gjocat”. Palët mund të apelojnë vendimet e AK përpara gjykatave.

Sa i përket *kapacitetit të zbatueshmërisë së ligjit*, AK ka një staf prej 39 punonjësish, që konsiderohet i përshtatshëm. Niveli i ekspertizës është forcuar nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit në seminare dhe workshop-e. *Në zbatim të ligjit*, gjatë periudhës raportuese AK miratoi 46 vendime, duke përfshirë 2 vendime për marrëveshjet e ndaluara dhe 13 vendime autorizime për përqendrimet. Disa prej vendimeve të dhëna në fushën e marrëveshjeve të ndaluara dhe pozitës dominuese ose të kontrollit të përqendrimeve duket se kanë qenë efektive: që nga viti 2016 nuk janë raportuar aplikime për lehtësim nga gjocat dhe ka qenë nën hetim vetëm një rast i dyshuar për marrëveshje të ndaluar në tregun e shpërndarjes së filmave në kinema. AK duhet të forcojë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.”